



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.760/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit C. G., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.29/2023 të datës 21.02.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.189/2024 të datës 20.06.2024 në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 18.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit C. G. anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.29/2023 të datës 21.02.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.189/2024 të datës 20.06.2024 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti për krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.29/2023 të datës 21.02.2024, të dënuarin C. G., e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, të cilin do ta mbajë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 17.09.2022 e deri me datën 15.09.2023. Është obliguar i dënuari që ti paguajë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 300 € dhe shumë prej 50 € në emër të fondit

për kompensimin e viktimave të krimit. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda , me aktgjykimin PAKR.nr.189/2024 të datës 20.06.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, C. G. av. Ymer Koro nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovoj si të bazuar kërkesën dhe ti anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.435/2024, e datës 13.12.2024, ka propozuar, që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 lidhur me nenin 436 paragrafi 1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të mbrojtësit të dënuarit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe me shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit sepse gjykata e shkallës së parë me provat e administruara nuk dëshmoi dashjen si element thelbësor të kryerjes së kësaj vepre penale, pasi që kjo vërtetohet me faktin se i dënuari asnjërin prej të dëmtuarve nuk e ka njohur. Pretendohet më tutje se, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për arsye se në të nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatoj se sipas shkresave të çështjes dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallë së parë nga provat e administruara nuk është kontestuese se i dënuari C. G. ditën kritike me një thikë që kishte në dorë i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarve personave zyrtar, dhe kjo padyshim është vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor siç janë dëshmitë e dëshmitarëve dhe provave materiale akt ekspertimi mjeko ligjor mbi konstatimin e natyrës së lëndimeve trupore, e që kjo vërteton aspektin objektiv të veprës penale , mirëpo kjo gjykatë nuk ka mundur të pranoj konstatimin e gjykatës së shkallë së parë lidhur me aspektin subjektiv nëse vërtet i dënuari C. G. , me veprimet e tij kishte për qëllim dhe dashje për të privuar nga jeta tani të dëmtuarit apo vetëm shkaktimin e lëndimeve trupore.

Mirëpo në aktgjykimin e shkallës së parë nuk ka arsytim për faktet vendimtare, për ato që paraqesin elemente qenësore të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, siç me vend theksohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë se a ka ekzistuar dashja e të dënuarit për kryerjen e kësaj vepre penale si element thelbësor e kësaj vepre penale.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar dashjen e të dënuarit siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 21 të KPRK-së “Vepra penale është kryer me dashje kur kryesi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe ka dashur që ta kryejë, apo kur ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit të tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, por e ka pranuar, është dakorduar që të shkaktohet ajo pasojë...”, mirëpo në rastin konkret nga provat e administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe të provave personale dhe materiale sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk rezulton se janë përmbushur elementet e veprës penale të vrasjes të mbetur në tentativë, ashtu që në rastin konkret nga gjykatat nuk është arsyetuar ky element i kësaj vepre penale.

Në nenin 369 paragrafin 6 të KPP-së, është parashikuar se “Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsytet për çdo pikë të aktgjykimit”, ndërsa në paragrafin 7. të këtij neni është parashikuar se “Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsytet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsytet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij”.

Bazuar në këto dispozita ligjore, rezulton se gjykata duhet që në arsyetimin e aktgjykimit të paraqes arsytet për çdo pikë të aktgjykimit (paragrafi 6. i nenit të lartcekur), ndërsa paraqitja e arsyeve ka të bëjë si me aspekte faktike, ashtu edhe me aspekte juridike të rastit përkatës.

Në këtë drejtim, mos paraqitja e arsyeve në aktgjykim në lidhje me aspektet e theksuara më lartë sipas dispozitave të lartcekura ligjore, konsiderohet shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 384, paragrafi 2., nën-paragrafi 7. të KPP.

Nga këto që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që në arsyetimin e aktgjykimit të saj të paraqes arsye të qarta dhe të mjaftueshme në lidhje me faktet relevante juridike, e që rezulton se këtë të rast, aktgjykimi në fjalë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje këto të përmendura më lart.

Në këtë drejtim, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, nuk është e mjaftueshme vetëm të paraqiten provat të cilat janë administruar, por duhet të konstatohet se çka është vërtetuar me ato prova dhe a është vërtetuar se te i dënuari ka ekzistuar dashja për kryerjen e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate,

gjykata e shkallës së parë në bazë të përshkrimit faktik të veprimeve të të dënuarit nuk ka arritur që ta vërtetoj se tek i dënuari a ka ekzistuar dashja si element i veprës për kryerjen e kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor.

Andaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate të gjitha këto përbëjnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat aktgjykimet e kundërshtuara i bëjnë juridikisht të paqëndrueshëm dhe të cilat domosdoshmërisht edhe kanë kushtëzuar anulimin e aktgjyimit në fjalë.

Nga të theksuarat si më lartë, Kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nën paragrafi 2.7 të KPP, pasi që i mungon plotësisht arsyetimi përkitazi me faktet vendimtare. Në këtë mënyrë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç është theksuar edhe më lart dhe këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Andaj, mbi bazën e të gjitha këtyre që u theksuan më lart, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi që ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit C. G., ndërsa të anulohen aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që kjo çështje penale do t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat janë përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktoj edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitohet të gjitha shkeljet e lartcekura, ku pas administrimit të serishëm të të gjitha provave, duhet të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjyimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

Pml.nr.760/2024, më datë 18.12.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka